



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr. 378/1 Prot.

Gjirokastrë, më 31/03/2021

V E N D I M

Nr. 09, datë 31.03.2021

**MIRATIMI I FORMËS SË DIPLOMËS PËR PROGRAMIN E CIKLIT TË DYTË
"MASTER I SHKENCAVE" NË FINANCË KONTABILITET**

Në mbështetje të ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 91, pika 3, udhëzimit nr. 1, datë 14.01.2020 për "Dokumentacioni dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", Kreu IV, vendimit të Senatit Akademik, nr. 42, datë 21.12.2020 "Miratimi i hapjes së programeve të reja të studimit", udhëzimit nr. 10, datë 30.03.2020 "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga IAL dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor", Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej", në mbledhjen e tij të datës, 31.03.2021;

V E N D O S I:

1. Të miratojë formën e diplomës të ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave" në Financë Kontabilitet, program i cili realizohet me 120 kredite në 2 (dy) vite akademike.
2. Formati i diplomës i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK


Prof. dr. Bektash MEMA

